

VENDIM
Nr. 118, datë 13.2.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 109, DATË 15.2.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
MBROJTJES TE MINISTRIA E BRENDSHME DHE TE MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT, PËR DREJTORINË RRUGORE SHKODËR, TË DISA OBJEKTEVE E
TË TRUALLIT FUNKSIONAL, PJESË TË PRONËS NR. 426, ME EMËRTIM “SHTABI I
BRIGADËS SË ARTILERISË”, ME VENDNDODHJEN NË RRENC, SHKODËR, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE,
TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”,
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr. 109, datë 15.2.2012 të Këshillit të Ministrave, fjalët “... sipërfaqe të përgjithshme 28 170.3 (njëzet e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë pikë tre) m², pjesë e pronës nr. 426, me emërtim “Shtabi i Brigadës së Artilerisë”, me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi ...”, zëvendësohen me fjalët “... sipërfaqe të përgjithshme 31 165.2 (tridhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë dy) m², pjesë e pronës nr. 426, me emërtim “Shtabi i Brigadës së Artilerisë”, me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi ...”.

2. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha